UDHËZIM
Nr. 398/1, datë 26.10.2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 398, DATË 3.6.2026, "PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT, EMËRIMIT, PEZULLIMIT, LIRIMIT DHE TË DISIPLINËS PËR MJEKËT NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, NËPËRMJET PLATFORMËS ELEKTRONIKE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 398, datë 3.6.2026, "Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për mjekët në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike", bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në kreun II, Shpallja e vendeve të lira të punës dhe aplikimi, shtohet pika 6, dhe ndryshohet pika 8:

a) në pikën 6, pas fjalisë së parë shtohet periudha e aplikimit:

"Afati i aplikimit në portal për mjekët specialistë/stomatologë është jo më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së vendit vakant, ndërsa për mjekët e përgjithshëm/mjekët e familjes aplikimi në platformë është i vazhdueshëm.";

b) pika 8 ndryshohet dhe bëhet:

"Kandidatët, të cilët në momentin e aplikimit rezultojnë të punësuar në një institucion shëndetësor publik, nuk kanë të drejtë të aplikojnë dhe të marrin pjesë në procedurat e konkurrimit të zhvilluara nëpërmjet kësaj platforme.

Përjashtimisht nga ky rregull, mund të aplikojnë për pozicione të lira në spitalet rajonale ose bashkiake mjekët specialistë të punësuar në institucionet publike shëndetësore, të cilët nuk kanë një kontratë me MSHMS-në.".

2. Pika 1, e kreut III: riformulohet si më poshtë vijon:

"1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve kryetar, dhe krijohet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) DQOSHKSH-ja krijon komisione *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve për pozicionet mjek specialist në spitalet rajonale, bashkiake dhe ditore, si dhe për pozicionet mjek specialist në NJVKSH dhe në qendrat shëndetësore, me këtë përbërje:

i. një përfaqësues i DQOSHKSH-së;

ii. drejtori i DROSHKSH-së ose një përfaqësues i caktuar prej tij;

iii. drejtori i institucionit ose një mjek i institucionit shëndetësor në të cilin ndodhet vendi vakant, i caktuar nga drejtuesi i këtij institucioni;

b) DQOSHKSH-ja krijon, për çdo rajon, komisionin për vlerësimin e kandidatëve për pozicionet mjek familjeje/mjek i përgjithshëm, me këtë përbërje:

i. një përfaqësues i DQOSHKSH-së;

ii. drejtori i DROSHKSH-së ose një përfaqësues i caktuar prej tij;

iii. një përfaqësues nga NJVKSH-të ose qendrat shëndetësore të rajonit përkatës, i caktuar nga MSHMS-ja.

Përbërja e këtij komisioni ndryshohet periodikisht, të paktën një herë në vit;

c) Titullarët e spitaleve universitare, spitaleve terciare dhe institucioneve qendrore në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë krijojnë komisione *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve për pozicionet mjek në institucionet që drejtojnë, me këtë përbërje:

i. drejtori, nëndrejtori ose një përfaqësues tjetër i institucionit;

ii. shefi i shërbimit përkatës ose një mjek i këtij shërbimi, i caktuar nga drejtuesi i institucionit;

iii. një përfaqësues i caktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

d) Njësitë e burimeve njerëzore në drejtoritë rajonale të OSHKSH-së për rajonin përkatës, si dhe njësitë e burimeve njerëzore të spitaleve universitare/terciare dhe institucioneve qendrore në varësi të MSHMS-së kryejnë rolin e Sekretariatit Teknik të platformës “Mjek për Shqipërinë” dhe kryejnë detyrat e mëposhtme:

i. administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin “Mjek për Shqipërinë”;

ii. kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit të depozituar, në përputhje me kërkesat e dosjes së aplikimit të përcaktuara në kreun II, pika 5, të këtij udhëzimi;

iii. i vë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit, listën e kandidatëve dhe informacionin mbi verifikimin paraprak të dokumentacionit të dosjes së aplikimit;

iv. dërgon për publikim në platformën “Mjek për Shqipërinë” pranë DQOSHKSH-së emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit, si dhe i njofton ata për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të fazës II;

v. njofton nëpërmjet postës elektronike, kandidatët e kualifikuar për vlerësimin e dosjes ashtu edhe ata të cilët nuk janë kualifikuar, duke specifikuar qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme arsyet e moskualifikimit;

vi. administron ankesat dhe ia paraqet Komisionit për shqyrtim;

vii. dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH vendimin përfundimtar të Komisionit për renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit;

viii. dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurrimit pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së apo drejtorisë së institucionit përkatës;

ix. plotëson formularin e inventarit të dokumenteve të ngarkuara *online* nga kandidati dhe formularin e inventarit të procedurës sipas periudhave të aplikimit (shtojcat nr. 5 dhe nr. 6).”.

3. Kreu VIII, pika 4, bëhet:

“4. Në rastin e pezullimit të mjekut nga detyra, procedura, kohëzgjatja dhe pasojat financiare të pezullimit përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës dhe ushtrimin e profesionit të mjekut, sipas rastit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE
Klodiana Spahiu